

# DR. HASSAN MAGHAIREH

## KURSET E SIMPOZIUMIT

### Kursi 1: Menaxhimi Kirurgjikal i Indeve të Buta në Implantologjinë Dentare

9:30 - 13:00

Kjo punëtori (workshop) ka për qëllim të ju ofrojë pjesëmarrësve të kursit aftësitë mikro-kirurgjike të nevojshme për të kryer teknika të ndryshme të graftimit të indeve të buta te rastet implantologjike dhe të kryejnë teknika estetike të suturimit për të ruajtur stabilitetin e indeve të buta dhe për të arritur rezultate të mira të indeve të buta peri-implantare. Ky kurs do të përfshijë një leksion dhe një hands-on punëtori mbi kokat e kafshëve për të demonstruar aftësitë që mësohen si pjesë e këtij trajnimit.

#### Qëllimet dhe Objektivat:

- Graft i indit të lirë lidhor
- Graft gingivar me trashësi të plotë
- Teknika të ndryshme të lambove në implantologji
- Teknika të ndryshme të suturimit në implantologji

Numri I pjesëmarrësve:

**Minimum 12 dhe Maksimum 20**

Pagesa: **70 Euro\***

Gjuha: Anglisht / Shqip / Maqedonisht

Secili pjesëmarrës do të ketë një kokë kafshe (qengj), material për suturim, instrumente mikrokirurgjike nga Devemed, Mantel, Doreza, Mbulesa tavoline, Maska.

*\*Dentistët të cilët to të regjistrohen në dy kurset: pagesa është 150 Euro*

Për të regjistruar kursin kliko [këtu](#)

### Kursi 2: Menaxhimi Protetikor i indeve të buta në Implantologji

14:00 - 17:30

Kjo punëtori (workshop) ka për qëllim të ju sigurojë pjesëmarrësve të kursit aftësitë protetikore të nevojshme për skulpturim, konturim, menaxhim dhe ruajtje të indeve peri-implantare. Kursi do të përfshijë të përkohshmet estetike, marrjen e masës dhe dizajnin përfundimtar të restaurimit në zonën estetike. Ky kurs do të përfshijë poashtu një leksion dhe puntori hands-on në krijimin e një kurore estetike të përkohshme gjatë pritjes së pacientit, në të njëjtën kohë.

#### Qëllimet dhe Objektivat:

- Të kuptuarit e dizajnit të saktë protetik mbi maturimin biologjik të indeve peri-implantare
- Mësoni se si të përshtatni kunjat për marrje mase në rastet estetike
- Kuptimi i rëndësisë së dizajnit protetikor në menaxhimin afatgjatë të indeve të buta.

Numri I pjesëmarrësve:

**Minimum 12 dhe Maksimum 20**

Pagesa: **120 Euro\***

Gjuha: Anglisht / Shqip / Maqedonisht

Secili pjesëmarrës do të ketë një model implanti, abutment të përkohshëm dhe kurore të përkohshme. Organizatori do të ofrojë setin protetikor, materialin nga kompoziti, dritën, kundërkëndin, mikrometrin, frezat finalizuese dhe setin restorativ.

*\*Dentistët të cilët to të regjistrohen në dy kurset: pagesa është 150 Euro*

Për të regjistruar kursin kliko [këtu](#)